



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.70, datë 30.03.2023

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE ARSYEVE TË LEJIMIT TË KANDIDATIT PËR MAGJISTRAT PËR T’U EMËRUAR NË VITIN PASARDHËS”

Bazuar në nenin 189, pika 1, germa “c” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 35 pika 5 dhe nenin 174 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozim të grupit të punës të ngritur me Urdhrin Nr.188, datë 30.12.2022, Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për “Përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magjistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës” të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magjistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, më 30.03.2023

KRYETAR

